



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 shkurt 2022
Nr.ref.: RK 1949/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI184/21

Parashtrues

Sabrije Bytyqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
Rev.nr.76/2021 të 18 majit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sabrije Bytyqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) nga fshati Senik, komuna e Malishevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Rev.nr.76/2021], të 18 majit 2021, përmes të cilit pretendohet se është shkelur nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).
3. Parashtruesja e kërkesës ka pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 14 qershor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 tetor 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 13 tetor 2021, parashtruesja e kërkesës dorëzoi dokument shtesë lidhur me kërkesës nr. KI184/21.
8. Më 14 tetor 2021, parashtruesja e kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 18 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
10. Më 16 dhjetor 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dhe Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh që të dorëzojnë fletëkthesën që tregon datën kur parashtruesja e kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

11. Më 23 dhjetor 2021, Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë njoftoi Gjykatën se parashtruesja e kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 14 qershor 2021.
12. Më 2 shkurt 2022, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rrjedh se më 5 tetor 2015 në fshatin Semetisht, komuna e Suharekës, drejtuesi i automjeti i markës “Jetta” me targa të regjistrimit 04-106-FH i siguruar tek kompania e sigurimeve “Elsig” me seli në Prishtinë kishte humbur kontrollin në automjet duke dalë nga rruga me ç ‘rast kishte ndodhur aksident i rëndë i trafikut duke e goditur parashtruesen e kërkesës. Nga ky aksident parashtruesja e kërkesës kishte humbur njërin sy dhe po ashtu kishte pësuar edhe lëndime tjera të rënda trupore që kishin rezultuar me zvogëlim të aktivitetit jetësor, zvogëlim të aktivitetit punues, dhimbje, frikë si dhe nevojë për kujdesin e huaj.
14. Më 4 dhjetor 2015, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, S.B., i ishte drejtuar kompanisë së sigurimeve “Elsig” me një shkresë të titulluar “kërkesë për kompensim dëmi sipas bazave nga autopërgjegjësia.” Në atë kërkesë ishte cekur: **(i)** se më 5 tetor 2015, parashtruesja e kërkesës kishte pësuar dëm të rëndë shëndetësor dhe se automjeti që ka shkaktuar aksident ka qenë i mbuluar me polisë sigurimi nr.0005540879 tek kompania e sigurimeve “Elsig”; **(ii)** në bazë të raportit policor dhe mjekësor, parashtruesja e kërkesës ka humbur njërin sy përjetësisht; **(iii)** si pasojë e aksidentit parashtruesja e kërkesës ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor, zvogëlim të aktivitetit punues, ka dhe do të ketë fitim të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe punues; **(iv)** lutet kompania e sigurimeve “Elsig” që të bëjë kompensimin në pajtim me rregullat në fuqi për shkak të pasojave të aksidentit derisa të ekzistojnë kushtet ligjore ashtu që të shmangen shpenzimet e procedurave gjyqësore eventuale; **(v)** që të kompensohen dhimbjet shpirtërore të prindërve të parashtrueses së kërkesës, F.B., dhe Sh.B., në pajtim me ligjet në fuqi; **(vi)** që për shkak të gjendjes së rëndë financiare të F.B., dhe Sh.B., dhe parashtrueses së kërkesës si dhe karakterit të dëmtimit të kësaj të fundit, në pajtim me rregullat në fuqi, të paguhet një paradhënie-akontacion që në fund do të zbritet nga kompensimi.
15. Më 27 qershor 2016, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës përsëriti kërkesën për kompensim tek kompania e sigurimeve “Elsig.”
16. Në një datë të paspecifikuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kishte paraqitur padi kundër kompanisë së sigurimeve “Elsig” në Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) me ç ‘rast kishte kërkuar **(i)** që të detyrohet kompania e sigurimeve “Elsig” që për dëmin material dhe jo material parashtrueses së kërkesës t’ia kompensojë dhimbjet fizike e shpirtërore, frikën e përjetuar, ushqim të përforcuar me ndihmë të personit të tretë, shpenzimet për mjekim klimatik, shëmtim, zvogëlim të aktivitetit punues e jetësorë si dhe forma të tjera të dëmit që parashihen në LMD; **(ii)** paditësit e dytë F.B., dhe Sh.B., për dëmin jo material t’i kompensojë

për dhimbje shpirtërore me kamatë 12% të bazuar në nenin 26 (6) të Ligjit për Sigurim nga Autopërgjegjësia.

17. Më 3 prill 2017, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës kishte precizuar kërkesëpadinë me ç' rast kishte kërkuar që **(i)** parashtruesja e kërkesës të kompensohet në shumën e përgjithshme prej 86,867.00 euro dhe rentën mujore në shumën prej 160,62 euro në muaj duke filluar nga data 19.02.2017 nga dt.01 deri 05., të muajit vijues derisa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore; **(ii)** që paditësve F.B., dhe Sh.B., në emër të dëmit jo material për shkak të invaliditetit të bijës së tyre parashtrueses së kërkesës, të detyrohet e paditura kompania e sigurimeve "Elsig" që këtyre të parëve t'ua kompensojë secilit veç e veç shumën prej 10,000.00 euro ose të dyve së bashku shumën prej 20,000.00 euro me kamatë ligjore prej 12% duke e llogaritur nga data e aksidentit të 05.10.2015 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 5,267.07 euro.
18. Pala e paditur kompania e sigurimeve "Elsig" kishte kontestuar kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Sa i përket parashtrueses së kërkesës baza juridike nuk është kontestuese por vetëm lartësia e kërkesëpadisë, ndërsa sa i përket paditësve F.B., dhe Sh.B., kërkesëpadia e tyre kontestohet sepse nuk është mbështetur me prova duke theksuar se gjykata nuk ka dërguar provat me të cilat do të vërtetohej fajësia apo pafajësia e shkaktarit të aksidentit.
19. Më 25 prill 2017, Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit C.nr.480/2015 miratoi pjesërisht padinë e parashtrueses së kërkesës dhe paditësve F.B., dhe Sh.B., dhe detyroi palën e paditur kompaninë e sigurimeve "Elsig" që paditësve t'ua kompensojë dëmin material dhe jo material.
20. Gjykata Themelore përcaktoi se parashtrueses së kërkesës në emër të dëmit jo material t'i kompensohet shuma prej 10,000.00 euro, në emër të të gjitha formave të dhimbjeve fizike shumën prej 12,000.00 euro, në emër të të gjitha formave të frikës 35,000.00 euro për zvogëlim të aktivitetit jetësor deri në 40%, 12,000.00 euro në emër të shëmtimit trupor.
21. Gjykata Themelore përcaktoi se parashtrueses së kërkesës në emër të dëmit material t'i kompensohet shuma prej 700 euro në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit tjetër në kohëzgjatje prej 35 ditësh; 750 euro në emër të ushqimit të përforcuar në kohëzgjatje prej 50 ditësh; 1,000.00 në vit në emër të ndërrimit të protezave të syrit deri sa për këtë ekzistojnë kushtet ligjore.
22. Gjykata Themelore po ashtu përcaktoi: **(i)** DETYROHET e paditura që t'ia paguaj parashtrueses së kërkesës në emër të dëmit jo material dhe material gjithsej shumën 71,450.00 euro, njëherit detyrohet e paditura që parashtrueses për çdo vit duke filluar nga viti 2017 në emër të ndërrimit të protezave të syrit t'ia paguaj 1,000.00 euro në vit derisa për këtë ekzistojnë kushtet ligjore; **(ii)** DETYROHET e paditura që t'ia paguaj parashtrueses në emër të rentës mujore duke filluar nga dt.19.02.2017 shumën mujore nga 160.62 euro për çdo muaj të vitit kalendarik nga dt.01 deri dt.05 të çdo muaji në llogarinë bankare të parashtrueses derisa ajo i plotëson kushtet ligjore për këtë kategori; **(iii)** OBLIGOHET e paditura që paditësve F.B., dhe Sh.B., për shkak të dhimbjeve

shpirtërore-për shkak të invaliditetit të rentës të pësuar në aksidentin e komunikacionit-humbjen e njërit sy çdo njërit veç e veç t'ua paguajë 8,000.00 euro apo të dyve së bashku prej 16,000.00 euro, njëherit detyrohet e paditura që paditësve shumat e cekura më lartë t'ua paguajë me kamatë vjetore 12% në vit nga data e aksidentit 05.10.2015; **(iv)** DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve kontestimore t'i paguaj këto shuma: për përpilimin e padisë shumë prej 490.88 euro, për të autorizuarit e paditësve për seanca të mbajtura nga 540 euro duke llogaritur TVSH 18 % apo 97.34 euro, gjithsej një seancë 638.14 euro që gjithsej bëjnë 3828.84 euro, për precizimin të lartësisë së kërkesëpadisë 490.88 euro, për një seancë të pa mbajtur 319.07 euro, në emër të ekspertizave, super-ekspertizave shumë prej 1057euro, detyrohet e paditura që t'i paguaj këto shpenzime si dhe të gjitha mjetet në emër të kategorive siguruese, dëmit material, jo material, rentës në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm; **(v)** REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve mbi shumat e kërkuara si dhe për paditësen-parashtruesen (Sabrije Bytyqi) në emër të dëmit material sa i përket rehabilitimit klimatik në mungesë të provave materiale.

23. Gjykata Themelore arsyetoi **(i)** se në kuptim të nenit 8 të LPK-së vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku; **(ii)** ka vlerësuar opinionet e ekspertëve mjeko-ligjor nga lëmi i ortopedisë, oftomatologjisë, psikiatrisë dhe ekspertit financiar; **(iii)** mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë për parashtruesen e kërkesës por lartësia e kërkesëpadisë; **(iv)** miratohet pjesërisht kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës duke pasur për bazë lëndimet e parashtruese së kërkesës e cila në aksident kishte humbur njërin sy; **(v)** parashtruesja e kërkesës ka humbje të ashtuquajtur anatomike të syrit që është humbje e përjetshme që ka rezultuar me 40% zvogëlim të aktivitetit punues dhe se ky mendim është mbështetur edhe në tabelat e Ministrisë së Shëndetësisë të vitit 2016 konform tabelave të BE-së; **(vi)** bazuar në opinionet e ekspertëve mjeko-ligjor të lëmit të ortopedisë, oftomatologjisë, psikiatrisë është miratuar pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.B., dhe Sh.B., për shkak të dhimbjeve shpirtërore të tyre për lëndimet e bijës së tyre; **(vii)** neni 172 i LMD-së përcakton se bashkëshortit, prindërve, fëmijëve u caktohet shpërblim i drejtë në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore; **(viii)** pala e paditur kompania e sigurimeve "Elsig" ka rënë në vonesë lidhur me shpenzimet mjekësore (ndërrimi i protezës së syrit) të parashtrueses së kërkesës prandaj lartësia e kamatës është caktuar në 12% nga data e aksidentit 05.10.2015 në pajtim me nenin 26 (6) të Ligjit nr.04/L-018 për sigurimin nga autopërgjegjësia; **(ix)** nga provat e nxjerra në procedurën provuese del qartë përgjegjësia e palës së paditur kompanisë së sigurimeve "Elsig" që të kompensojë dëmin në të gjitha format e tij të përshkruara në dispozitivin e këtij aktgjykimi.
24. Pala e paditur kompania e sigurimeve "Elsig" kishte paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në shkallë të parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

25. Më 23 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3258/17] përcaktoi: **(i)** APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e paditurës Kompania e Sigurimeve "Elsig", në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C.nr.480/15, i datës 25.04.2017, në pikën II të dispozitivit lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike, frikës, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë dhe shëmtimit trupor të shkallës së mesme, NDRYSHOHET dhe gjykohet: detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Elsig", në Prishtinë, që paditëses-parashtrueses (Sabrije Bytyqi), t'ia paguaj në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 7.000 euro, për frikë shumën prej 5.000 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 17.500 euro pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara për këto forma të dëmit REFUZHET SI E PABAZUAR; **(ii)** APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "Elsig", në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore C.nr.480/15, i datës 25.04.2017, në pikën II të dispozitivit lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditet të rëndë të pësuar, NDRYSHOHET dhe gjykohet: detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Elsig", në Prishtinë, që paditësve F.B., dhe Sh.B., që në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të invaliditet të rëndë që ka pësuar bija e tyre e mitur, t'ua paguaj shumën nga 5.000 euro secilit veç e veç, pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara për këto forma të dëmit REFUZHET SI E PABAZUAR; **(iii)** REFUZHET pjesërisht ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "Elsig", në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C.nr.480/15, i datës 25.04.2017, sa i përket pjesës së dëmit jo material dhe atë sa i përket shëmtimit trupor në shumë prej 12.000 euro, për dëmin material përkatësisht në emër të ndërrimit të protezave të syrit për çdo vit në shumën prej 1.000 euro, duke filluar nga viti 2016 e deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore si dhe renta mujore në shumë prej 160.62 euro në muaj duke filluar nga data 19.02.2017 deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të ndihmës së huaj prej 750 euro si dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 700 euro, VËRTETOHET.
26. Gjykata e Apelit arsyetoi: **(i)** nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 i LPK-së; **(ii)** në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare sipas të cilave edhe është vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë; **(iii)** gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe se nuk është kontestues fakti se aksidenti i komunikacionit i datës 05.10.2015 ishte shkaktuar me fajin e të siguruarit të palës së paditur kompania e sigurimeve "Elsig"; **(iv)** parashtruesja e kërkesës ka pësuar humbje anatomike të syrit çka ia ka zvogëluar aktivitetin punues në 40% pavarësisht moshës së saj të re; **(v)** vendosi si në pikën një dhe dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategoritë e dëmit jo material pasi që vlerësoi se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi; **(vi)** vendosi si në pikën një dhe dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u siguruar se shuma e gjykuar përfaqëson një kompensim të drejtë si satisfakcion me qëllim të zbutjes së pasojave duke ofruar përmes kompensimit adekuat një kënaqje tek paditësja (parashtruesja e kërkesës) si mënyrë e kompensimit në pamundësi të rikthimit të gjendjes së mëparshme; **(vii)** edhe në rastin e vendosjes për paditësit gjegjësisht prindërit e paditëses të cilët kanë ndjerë dhe do të ndjejnë dhimbje shpirtërore gjatë gjithë

jetës për pasojat e rënda të pësuarra vajza e tyre e mitur në moshën e hershme të saj; **(viii)** lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit, Gjykata e Apelit, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse shumica e gjykuar është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me gjendjen faktike, të gjeturat nga ekspertizat mjekësore dhe përbejnë dëm të ardhshëm të sigurt material, si pasojë e lëndimeve të përhershme që ka pësuar paditësja në syrin e saj; **(ix)** vendimi mbi kamatën është në përputhje me dispozitat e LMD-së.

27. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës paraqiti revizion kundër aktgjykimit të shkallës së dytë duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale në pjesën refuzuese, me propozim që revizioni të aprovohet ashtu që aktgjykimet e gjykatave të shkallës së ulët të ndryshohen dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit (parashtrueses së kërkesës) edhe për pjesën refuzuese.
28. Pala e paditur kompania e sigurime “Elsig” po ashtu paraqiti revizion duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni të aprovohet ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i shkallës së parë.
29. Më 18 maj 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.76/2021] përcaktoi: (i) Refuzohet i pabazuar revizioni i paditëses-parashtrueses së kërkesës i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr. 3258/17 të 23 dhjetorit 2019; (ii) Aprovohet pjesërisht i bazuar revizioni i të paditurës kompania e sigurimeve “Elsig” në Prishtinë dhe ndryshohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr. 3258/17 i 23 dhjetorit 2019 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore C.nr.480/15 i 25 prillit 2017 vetëm sa i përket kamatës në shumat e gjykuara, ashtu që detyrohet e paditura kompania e sigurimeve “Elsig” në Prishtinë, që paditëses-parashtrueses për shumat e gjykuara në emër të dëmeve jo materiale t’ia paguajë kamatën prej 8% nga dita e aktgjykimit të shkallës së parë, 25 prill 2017, e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ndërsa për shumat e gjykuara t’ia paguajë kamatën prej 8% nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e dëmit më datë 4 dhjetor 2015, e deri në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm; (iii) revizioni i të paditurës në pjesët përveç kamatës refuzohet si i pabazuar.
30. Gjykata Supreme arsyetoi: **(i)** revizioni i parashtrueses së kërkesës është i pabazuar kurse revizioni i palës së paditur kompania e sigurimeve “Elsig” është i bazuar vetëm sa i përket kamatës; **(ii)** lidhur me dëmin jo material drejtë është zbatuar neni 183 i LMD-së dhe se shpërblimi për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe nuk ka qëllim “lukrativ” fitimprurës; **(iii)** lartësia për shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore si dhe në harmoni me praktikën gjyqësore, prandaj, refuzohen pretendimet e revizionit të paditësve dhe të paditurve; **(iv)** refuzohen të pabazuara pretendimet e palës së paditur lidhur me rentën mujore dhe fitimin e humbur sepse eksperti financiar Sh.B., ka dhënë shpjegime të mjaftueshme që janë pranuar nga gjykatat e instancës më të ulët; **(v)** në rastin konkret paditësja (parashtruesja e kërkesës) ka paraqitur padinë ende pa kaluar afati ligjor nga neni 26 (1) dhe (5) i Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia që parashikon se i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në gjykatën kompetente në rast se siguruesi nuk i përgjigjet brenda afatit ligjor të

nenit 26 (1); **(vi)** paditësja (parashtruesja e kërkesës) duke mos e pritur këtë afat ka ushtruar padi para skadimit të afatit dhe e paditura është përgjigjur në padi duke mos e kontestuar bazën juridike të kompensimit për paditësen por vetëm shumat e kërkuara, ndërsa duke e kontestuar edhe bazën juridike dhe mungesën e provave për paditësit F.B., dhe Sh.B., **(vii)** prandaj, gabimisht është aplikuar neni 26 i Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësive, është aplikuar e shkalla se kamatës prej 12%, ndërsa duhet të jetë në shkallë prej 8%; **(viii)** gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka aplikuar ligjin sa i përket kohës së aplikimit të kamatës sepse për dëmin jo material kamata fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive, ndërsa për kompensimin e dëmit material nga dita e paraqitjes së kërkesës; **(ix)** prandaj, Gjykata Supreme në zbatim të së drejtës materiale lidhur me kamatat vendosi që e paditura për shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material duhet t'u paguajë paditësve kamatën prej 8% nga dita e aktgjykimit të shkallës së parë 25 prill 2017; **(x)** ndërsa për shumat e gjykuara në emër të dëmit material t'ua paguajë kamatën prej 8% nga dita e paraqitjes së kërkesës më 4 dhjetor 2015.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
32. Parashtruesja e kërkesës thekson se është e pakënaqur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë dhe pjesën e zvogëluar të kamatëvonesës nga 12% në 8% në vit.
33. Parashtruesja e kërkesës pretendon: *“Parashtruesja konsideron se me aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, me aktgjykimin e shkallës së dytë në pjesën aprovuese të ankesës së të paditurës në mos deklarinim e gjykatës së Apelit lidhur me ankesën e paditëses, si dhe me aktgjykimin e Revizionit me ndryshim të gjykimin të kamatëvonesës nga 12 % në 8 % , me vendimet e kontestuara përveç shkeljeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka shkelje edhe nga Neni 6 i KEDNJ, dhe neni 10 i Deklaratës Universale.”*
34. Parashtruesja e kërkesës pretendon: *“Me vendimet e sipërcituara në pjesët refuzuese të ankesës dhe në pjesët ndryshuese të gjykimin, parashtruesja konsideron se të njëjtës i janë shkëlur të drejtat në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ngase palët në procedurë nuk janë trajtuar barabarësisht, sepse gjykata e Apelit e Kosovës fare nuk e ka trajtuar ankesën e paditëses në pjesën refuzuese të aktgjykimin të shkallës së parë të ankimit me ankesë, dhe se vendimi i Revizionit e ka zbrit kamatëvonesën nga 12 % në vit sa ka qenë e gjykuar nga dy instanca gjyqësore në 8 % ne vit, në kundërshtim me ligjin e veçantë (Ligji 04/L-018, neni 26.6) në dëm të ankueses.”*
35. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh lartësinë e kompensimit në krahasim me të mirën që i është dëmtuar asaj.

36. Parashtruesja e kërkesës pretendon: “Aktgjykimet e gjykatave në pjesën refuzuese gjykata e shkallës së parë, në pjesën ndryshuese Gjykata e Apelit në pjesën e mos shqyrtimit të ankesës Gjykata e Supreme në pjesën e ndryshimit të kamatës, nuk kanë dhënë arsye të bazuara për këto veprime dhe mos veprime.”
37. Në fund, Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: “Të njëjtat aktgjykime në pjesët refuzuese të kërkesëpadisë së paditëses dhe në pjesën e ndryshimit të gjyqimit të kamatëvonesës të shfuqizohen dhe shpallen të pavlefshme dhe rasti të rigjykohet në pajtim me ligjet në fuqi, në një procedurë të rregullt dhe të paanshme.”

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE Nr. 03/L-006

Neni 8

8.1 Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.

8.2 Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç'do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjyqimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

a) në çoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në çoftë se në nxjerrjen e aktgjyqimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;

b) në çoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;

c) në çoftë se në nxjerrjen e aktgjyqimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies së vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;

d) në çoftë se gjykata sipas prapsmiit të palëve gabimisht ka vendosur se është e kompetencës lëndore;

e) në qoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;

f) në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;

g) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji); h) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerr aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;

i) në qoftë se ndonjëres nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;

j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;

k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;

l) në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykim i formës së prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;

m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

n) në qoftë se aktgjykim i ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykim i nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

o) në qoftë se me aktgjykim është tejkalluar kërkesëpadia.

Neni 183

183.1 Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

183.2 Ekziston konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike edhe kur për këtë flasin faktet e reja apo provat e reja.

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE NR. 04/L-077

Neni 172

Shpërblimi në formë të rentës në të holla

1. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.

2. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër.

3. Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme.

4. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse.

5. Për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme.

Neni 183

Shpërblimi në të holla

1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

NËNKREU 3

VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA

Neni 382 Kamatëvonesa

1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.
2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

LIGJI PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA NR. 04/L-018

Neni 26 Procedura e kërkesave për dëmshpërblim

1. Siguruesi është i detyruar që, për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me:

1.1. ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse;

1.2. vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.

2. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën. Prej ditës së pranimit, respektivisht kompletimit të dokumentacionit të kërkesës, fillojnë të zbatohen afatet nga paragrafi 1. i këtij neni për detyrimin e siguruesit përkitazi me trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim.

3. BQK-ja nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe përcaktimin se kur konsiderohet e kompletuar kërkesa me prova dhe dokumentacionin e nevojshëm për të vendosur lidhur me dëmshpërblimin.

4. Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguajë palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni.

5. Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

6. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mospërbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

7. Dispozitat nga paragrafi 1., 2., 4. dhe 5. të këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në rastet e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim të cilat janë detyrim i byrosë për dëmet nga baza e sigurimit kufitar dhe detyrimet e Fondit të kompensimit.

8. Në kërkesat për dëmshpërblim nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit zbatohen procedura dhe afate të posaçme sipas Marrëveshjes së Kretës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Neni 113
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

41. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të saj. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.nr.76/2021], të 18 majit 2021, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parashikuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
42. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

43. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesën të papranueshme për arsye që ndërliken me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/21, parashtruese *Agjencia*

Kosovare e Privatizimit, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

44. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “*qartazi të pabazuar*”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “*qartazi të pabazuara*”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).
45. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
46. Gjykata përsëritë se esenca e këtij rasti është se parashtruesja e kërkesës në një aksident rrugor kishte humbur njërin sy dhe kishte pësuar edhe lëndime tjera trupore nga i siguruari i kompanisë së sigurimeve “Elsig”. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës kishte kërkuar kompensim material dhe jo material nga kompania e sigurimeve “Elsig”. Më pastaj, çështja ishte proceduar tek gjykatat e rregullta. Gjykata Themelore kishte akorduar kompensim material dhe jo material në dobi të parashtrueses së kërkesës dhe prindërve të saj për shkak të dëmit të pësuar. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dhe pala e paditur kompania e sigurimeve “Elsig” paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit kishte ndryshuar shumat e gjykuara për dëmin material dhe jo material por kishte vërtetuar kamatën vjetore në lartësi prej 12%. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dhe pala e paditur kompania e sigurimeve “Elsig” paraqitën revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit mirëpo e ndryshoi vetëm sa i përket lartësisë së kamatës përkatësisht e ndryshoi atë nga 12% në 8% në vit.
47. Gjykata rikujton që parashtruesja i kërkesës në thelb pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta në pjesët refuzuese të ankesës dhe në pjesët ndryshuese të gjykimit, asaj i janë shkelë të drejtat në gjykim të drejtë dhe të pa anshëm,

ngase palët në procedurë nuk janë trajtuar barabarësisht. Parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykata Supreme ka zbritur kamatëvonesën nga 12 % në vit sa ka qenë e gjykuar nga dy instanca gjyqësore në 8 % në vit, në kundërshtim me ligjin e veçantë për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia (Ligji 04/L-018, neni 26.6) në dëm të saj. Sipas parashtrueses së kërkesës të gjitha shkeljet e pretenduara procedurale e materiale të sipërpërmendura kanë rezultuar në shkelje të neneve 3, 24, 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së.

48. Lidhur me pretendimet e parashtrueses së kërkesës për ndryshimin e shumave të gjykuara, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit kishte konstatuar: **(i)** parashtruesja e kërkesës ka pësuar humbje anatomike të syrit çka ia ka zvogëluar aktivitetin punues në 40% pavarësisht moshës së saj të re; **(ii)** vendosi si në pikën një dhe dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategoritë e dëmit jo material pasi që vlerësoi se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi; **(iii)** vendosi si në pikën një dhe dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u siguruar se shuma e gjykuar përfaqëson një kompensim të drejtë si satisfakcion me qëllim të zbutjes së pasojave duke ofruar përmes kompensimit adekuat një kënaqje tek paditësja (parashtruesja e kërkesës) si mënyrë e kompensimit në pamundësi të rikthimit të gjendjes së mëparshme; **(iv)** edhe në rastin e vendosjes për paditësit gjegjësisht prindërit e paditëses të cilët kanë ndjerë dhe do të ndjejnë dhimbje shpirtërore gjatë gjithë jetës për pasojat e rënda të pësuarat vajza e tyre e mitur në moshën e hershme të saj; **(v)** lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit, Gjykata e Apelit, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse shumat e gjykuar është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me gjendjen faktike, të gjeturat nga ekspertizat mjekësore dhe përbejnë dëm të ardhshëm të sigurt material, si pasojë e lëndimeve të përhershme që ka pësuar paditësja në syrin e saj; **(vi)** vendimi mbi kamatën është në përputhje me dispozitat e LMD-së.
49. Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte vërtetuar konstatimet e Gjykatës së Apelit përveç lartësisë së kamatës për shumat e gjykuara përkatësisht e kishte ndryshuar lartësinë e kamatës nga 12% në 8%.
50. Në këtë drejtim, Gjykata vë në spikamë konstatimet e Gjykatës Supreme: **(i)** revizioni i parashtrueses së kërkesës është i pabazuar kurse revizioni i palës së paditur kompania e sigurimeve “Elsig” është i bazuar vetëm sa i përket kamatës; **(ii)** lidhur me dëmin jo material drejtë është zbatuar neni 183 i LMD-së dhe se shpërblimi për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe nuk ka qëllim “lukrativ” fitimprurës; **(iii)** lartësia për shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore si dhe në harmoni me praktikën gjyqësore, prandaj, refuzohen pretendimet e revizionit të paditësve dhe të paditurve; **(iv)** refuzohen të pabazuara pretendimet e palës së paditur lidhur me rentën mujore dhe fitimin e humbur sepse eksperti financiar Sh.B., ka dhënë shpjegime të mjaftueshme që janë pranuar nga gjykatat e instancës më të ulët; **(v)** në rastin konkret paditësja (parashtruesja e kërkesës) ka paraqitur padinë ende pa kaluar afati ligjor nga neni 26 (1) dhe (5) i Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia që parashikon se i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në gjykatën kompetente në rast se

siguruesi nuk i përgjigjet brenda afatit ligjor të nenit 26 (1); **(vi)** paditësja (parashtruesja e kërkesës) duke mos e pritur këtë afat ka ushtruar padi para skadimit të afatit dhe e paditura është përgjigjur në padi duke mos e kontestuar bazën juridike të kompensimit për paditësen por vetëm shumat e kërkuara, ndërsa duke e kontestuar edhe bazën juridike dhe mungesën e provave për paditësit F.B., dhe Sh.B., **(vii)** prandaj, gabimisht është aplikuar neni 26 i Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, është aplikuar e shkalla se kamatës prej 12%, ndërsa duhet të jetë në shkallë prej 8%; **(viii)** gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka aplikuar ligjin sa i përket kohës së aplikimit të kamatës sepse për dëmin jo material kamata fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive, ndërsa për kompensimin e dëmit material nga dita e paraqitjes së kërkesës; **(ix)** prandaj, Gjykata Supreme në zbatim të së drejtës materiale lidhur me kamatat vendosi që e paditura për shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material duhet t'u paguajë paditësve kamatën prej 8% nga dita e aktgjykimit të shkallës së parë 25 prill 2017; **(x)** ndërsa për shumat e gjykuara në emër të dëmit material t'u paguajë kamatën prej 8% nga dita e paraqitjes së kërkesës më 4 dhjetor 2015.

51. Pjesa relevante e aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton: *“Lidhur me pretendimin e të paditurës së gabimisht është kalkuluar renta mujore në shkresat e lëndës del se ekspertiza është shqyrtuar si provë dhe e paditura ka pas mundësinë e kundërshtimit dhe të gjitha pyetjet e parashtruara kanë marrë përgjigje në seancën e datës 31 tetor 2016 ku ka marrë pjesë edhe eksperti financiar Sh.B., i cili është obliguar që të plotësoi ekspertizën duke dhënë përgjigje në pyetjet e parashtruara. Në plotësimin e ekspertizës ai ka dhënë shpjegime të mjaftueshme të cilat ika pranuar gjykata e shkallës së parë dhe me të cilat pajtohet edhe gjykata e shkallës së dytë. Gjykata ka marrë në shqyrtim edhe ekspertizën e aktuarit A.B., i angazhuar nga kompania par jo edhe nga gjykata dhe përveç kësaj ka kërkuar edhe ekspertizë nga lëmi i medicinës së punës në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë. Prandaj Gjykata Supreme i refuzoi si të pa bazuara pretendimet e të paditurës lidhur me përcaktimin e rentës dhe fitimit të humbur. Gjykata Supreme gjeti se pretendimin e revizionit të paditurës se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, konkretisht nenin 26 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë, se gabimisht është aplikuar shkalla e kamatës prej 12%, i pranoi si të pa bazuar, sepse kamata në lartësi prej 12% ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për kompensim dëmi, por vetëm për vonesa të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblimin e dëmit në procedurë jashtë gjyqësore nga Kompanitë e Sigurimeve, ashtu siç parashihet në nenin 26(6) të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia [...] e paditura pohon se ka pasur vullnet të jep paradhënie dhe nuk ka kontestuar asnjëherë bazën ligjore për sa i përket paditëses Sabrije Bytyqi por në rastin konkret padia është paraqitur para kërkesës për kompensimin e dëmit gjegjësisht më 18 dhjetor 2015 ndërsa kërkesa për trajtimin e dëmit përmes paradhënies është bërë më 7 tetor 2016 gjegjësisht më 4 dhjetor 2015 ende pa kaluar afati ligjor në kuptim të nenit 26, paragrafi 1 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë ashtu siç parashihet në paragrafin 5 i cili parasheh se “Në rast se siguruesi përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në gjykatën kompetente”. Pra paditësja dhe duke mos e pritur këtë afat ka ushtruar padi para skadimit të*

afatit dhe e paditura është përgjigjur në padi duke mos e kontestuar bazën juridike të kompensimit për paditësen Sabrije Bytyqi por vetëm shumat e kërkuara, ndërsa duke e kontestuar edhe bazën juridike dhe mungesën e provave për paditësit F.B., dhe Sh.B., [...] Ndërsa sa i përket kohës së aplikimit të kamatave gjykata e shkallës së dytë ka aplikuar gabimisht ligjin duke vendosur se kamatat aplikohen nga dita e aksidentit për të gjitha shumat e gjykuara edhe Gjykata Supreme gjenë se pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit jo material, kamata fillon të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimi në gjykatën e shkallës së parë e deri në pagesën e plotë, ndërsa për kompensimin e dëmeve materiale nga dita e paraqitjes së kërkesës. Prandaj, Gjykata Supreme në zbatim të drejtës materiale lidhur me kamatat vendosi se e paditura për shumat e gjykuara në emër të dëmeve duhet t'ua paguajë paditësve, kamatën prej 8% nga dita e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, më 25 prill 2017, e deri në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, ndera për shumat e gjykuara për dëmet materiale t'ia paguajë kamatën prej 8% nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e dëmit më datë 4 dhjetor 2015.”

52. Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta sa u përket shumave të gjykuara të kompensimit për dëmin e pësuar kanë shpjeguar: **(i)** ato përfaqësojnë një kompensim të drejtë si “satisfakcion” me qëllim të zbutjes së pasojave dhe se nuk kanë karakter “lukrativ” fitimprurës për parashtruesen e kërkesës kurse; **(ii)** kurse sa i përket zvogëlimit të kamatës vjetore nga 12% në 8% Gjykata Supreme ka shpjeguar se parashtruesja e kërkesës ka ushtruar padi para skadimit të afatit ligjor përkatësisht para se të përgjigjej pala e paditur kompania e sigurimeve “Elsig”; **(iii)** rrjedhimisht, gabimisht është aplikuar e drejta materiale (neni 26 i Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë).
53. Gjykata rithekson se sa i përket gjyqësorit të rregullt, Gjykata Supreme është autoriteti me i lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës (shih nenin 103.2 të Kushtetutës) dhe se interpretimi i saj i dispozitave ligjore përkatëse dhe çështjeve tjera të ligjit mbizotëron ndaj interpretimeve ligjore të Gjykatave Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Në rastin konkret, vlerësimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga Gjykata Supreme nuk ngre çështje të garancive procedurale dhe materiale nga nenet 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI68/20, *Parashtrues Hysen Thaqi*, Aktvendim për papranueshmeri i 29 marsit 2021, paragrafët 44-45 dhe nr. KI37/21 *Parashtrues Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 shtatorit 2021, paragrafi 68).
54. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës përfitoi nga procedura kontradiktore dhe se ajo ishte në gjendje të paraqes në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ajo i konsideroi të rëndësishme për rastin e saj; ajo ka pasur mundësinë të hedh poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e saj, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe

30, shih gjithashtu rastin KI22/19, *Parashtrues Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

55. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “*qartazi i gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesen e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe se të njëjtat i kanë arsyetuar (Shih: në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI64/20, *Parashtrues i kërkesës, Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
56. Për sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës për cenim të së drejtës për barazi para ligjit siç garantohet me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës, Gjykata vëren se bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së në mënyrë që një çështje të ngrehet nën nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] aty duhet të ketë dallim në trajtim të personave në situata analoge ose që janë në mënyrë relevante të krahasueshme (shih, mes shumë autoritetesh tjera, *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Ruisë*, Aktgjykim 2017 paragrafi 64; *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 98; dhe *Konstantin Markin kundër Ruisë*, Aktgjykim 2012, paragrafi 125). Me fjalë të tjera, kriteri për demonstrimin e pozitës analoge nuk kërkon që grupet e krahasuara (*comparator groups*) të jenë identike. Një parashtrues duhet të demonstrojë, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankesës së tij apo të saj, që ai ose ajo ka qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme (*relevantly similar situation*) me të tjerët që janë trajtuar ndryshe (shih *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim 2010, paragrafi 66). Megjithatë, jo çdo dallim në trajtim rezulton me shkelje të nenit 14. Së pari, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se vetëm dallimi në trajtim bazuar në karakteristika të identifikueshme, ose “status”, janë në gjendje të rezultojnë me diskriminim në kuadër të nenit 14 (shih *Carson dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 61, dhe *Eëeida dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48420/10, paragrafi 86, Aktgjykim 2013). Së dyti, dallimi në trajtim është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih *Fabris kundër Francës* Aktgjykim 2013, paragrafi 56; *Topčić-Rosenberg kundër Kroacisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 36; dhe *Èeller kundër Hungarisë*, Aktgjykim 2009, paragrafi 27).
57. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës nuk ka treguar apo identifikuar individin apo grupin në krahasim me të cilin është diskriminuar dhe me të cilin ajo ka qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme. Barra e të provuarit për trajtim diskriminues bie mbi parashtruesen e kërkesës çka bazuar në shkresat e lëndës është evidente se

pretendimin për diskriminim ajo nuk e ka provuar. (shih rastin e Gjykatës nr. KI143/20 *Parashtrues Radovan Paunović*, Aktvendim për Papranueshmëri i 8 shtatorit 2021, paragrafi 55 dhe referencat nga jurisprudenca e GJEDNJ-së të përmendura aty).

58. Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 3, 24, 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
59. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 2 shkurt 2022, me shumicë

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani